

Konkluzionet e kryesuesit të BE-së në heqjen e barrikadave dhe revitalizimin e urës së Mitrovicës

Bruksel, 22 korrik 2014

Plani i BE-së përfshinë elementet në vijim:

Respektimin e ligjit të Kosovës;

Kryerjen e një vlerësimi teknik të stabilitetit të strukturës statike të Urës së Ibrit nga ana e BE-së;

Draftimin e një projekti për revitalizimin e Urës, si dhe zbatimin e revitalizimit/restaurimit të Urës së Ibrit nga ana e BE-së.

Palët poashtu u pajtuan në vazhdimin e moratoriumit që pengon çfarëdo akti të vendosjes së barrikadave në atë pjesë, e në rast të dështimit për t'iu përmbajtur këtij moratorium, institucionet relevante të Republikës së Kosovës do të veprojnë përmes forcës së ligjit për të siguruar zbatimin.

Në shtator 2014, ekspertët do të përfshihen nga BE-ja dhe do të prezantojnë të dalat e vlerësimit teknik për të vazhduar me revitalizimin e plotë dhe funksionalizimin e urës, me qëllim të lëvizjes së lirë.

Me propozimin e BE-së, u pajtua që të hiqen barrikadat dhe të revitalizohet ura në një proces gradual dhe paralel, një proces në të cilin BE-ja do të angazhohet direkt, përmes ofrimit të asistencës financiare për projektet që synojnë përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Mitrovicës.

(përkthim jo zyrtar)